

TeleArbëria (TVA), 5 May 2004

## **Intervistë me Ambasadorin Osmo Lipponen, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, për çështje zgjedhore**

*Nga Eva Simoni*

**TVA: Cili do të jetë kontributi i OSBE-së në përgatitjen për zgjedhjet e ardhshme?**

**Lipponen:** Jemi ende në fazën përgatitore, por ju siguroj se do të ketë një përfshirje mjaft aktive të OSBE/ODIHR-it dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Deri në një farë mase, ne mund të ndërmarrim veprime, por meqë pjesa më e madhe e kontributit tonë duhet të bazohet në bashkëpunimin e mirë me partnerët shqiptarë, është paksa tepër herët për të thënë me saktësi se çfarë do të bëjmë. Tani, jemi në fazën e diskutimit se çfarë duhet të bëjmë së bashku. Por, siç e kemi thënë më parë, ne do të japim mbështetjen tonë maksimale, në mënyrë që zgjedhjet parlamentare dhe përgatitjet për to të zhvillohen siç duhet, meqenëse këto zgjedhje janë vërtet vendimtare për vendin.

**TVA: Cilat janë disa nga rekomandimet që OSBE/ODIHR-i u ka bërë partive politike në vend?**

**Lipponen:** Rekomandimet kryesore janë, sigurisht, ato për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe rikompozimin e komisioneve zgjedhore, përmirësimin e listave të zgjedhësve, si dhe disa rekomandime, sipas të cilave duhet të thjeshtohet mënyra e shpërndarjes së mandateve parlamentare. Këto janë, në një farë mënyre, çështjet politike më të vështira. Ka edhe disa komente të vogla teknike për disa nene të Kodit Zgjedhor, të cilat janë kaq teknike, saqë nuk do të ketë ndonjë diskutim politik domethënës. Por pozitiv është fakti se të dyja partitë kryesore i kanë mirëpritur rekomandimet në parim. Gjithashtu, edhe komentet e pjesës tjetër të shoqërisë dhe sferës politike kanë qenë mjaft pozitive. Përkthimi në shqip i raportit ka vetëm disa ditë që ka dalë, kështu që jemi në pritje të komenteve të tjera. Atëherë do të jetë koha më e përshtatshme për të arritur në përfundime.

**TVA: A mendoni se do të gjeni mbështetjen e dy partive kryesore në vend për rikompozimin e KQZ-së?**

**Lipponen:** Jam i sigurt që do të ketë një zgjidhje. Nëse do të gjykoja komentet e para për raportin, meqenëse të dyja partitë e shohin pozitivisht atë, kjo do të thotë se ekziston një mundësi për të arritur një marrëveshje, dhe, profesionalisht, unë duhet të jem optimist.

**TVA: Çfarë kuptoni me balancimin e KQZ-së?**

**Lipponen:** Raporti i ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias paraqet ide të ndryshme se si mund të ri-balancohet KQZ-ja, sidomos me qëllim që vendimmarrja të mos sjellë bllokime. Gjithashtu, raporti rekomandon që duhet të ketë një qasje më profesionale në

KQZ. E gjithë kjo do të thotë se ata janë të mendimit se Kushtetuta nuk përbën pengesë, prandaj nëse duhet gjetur një zgjidhje për ta bërë KQZ-në një institucion që funksionon siç duhet, Kushtetuta mund të ndryshohet. Kjo ndryshon nga mendimi mbizotërues në Shqipëri.

**TVA: A ka kohë të mjaftueshme për ndryshime në Kodin Zgjedhor?**

**Lipponen:** Patjetër që ka kohë të mjaftueshme, pasi edhe deri tani është bërë mjaft punë profesionale: ODIHR-i përgatiti një raport të plotë për zgjedhjet e fundit të qeverisjes vendore, i cili përmban një sërë rekomandimesh dhe vërejtjesh, dhe tani kemi këtë raport edhe më të detajuar të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, gjë që do ta ndihmojë procesin ligjvënës. Mungesa e kohës lidhet me zbatimin. Ashtu siç ndodhi vitin e kaluar, kur Kodi i ri Zgjedhor hyri në fuqi dhe megjithë përpjekjet e KQZ-së të mbështetura nga ne, në terren, njohja e Kodit dhe e kërkesave të tij nuk ishte aq e thellë. Sa më shpejt që të përmirësohet Kodi tani, aq më shumë kohë do të kemi për trajnime lidhur me zbatimin e tij, si dhe për përmirësimin e listave të zgjedhësve, në të cilat do të përqendrohen përpjekjet kryesore të qeverisë dhe të gjithë shoqërisë, ku do të ketë nevojë për shumë mbështetje edhe nga komuniteti ndërkombëtar.

Tani po flasim për KQZ-në. Të paktën, për të ndryshuar përbërjen e KQZ-së ka kohë dhe, në parim, unë jam i mendimit se nëse ekziston vullneti politik, do të ketë kohë për të diskutuar edhe për sistemin zgjedhor. Por të gjitha këto diskutime duhet të përfundojnë, së shumti, në mes të verës. Gjithashtu, nëse ndryshon sistemi zgjedhor, atëherë duhen edhe më shumë kohë e burime për zbatim.

**TVA: Kohët e fundit Grupi i të Urtëve i iniciuar nga Presidenti ka bërë disa propozime. Sa mendoni se këto propozime do të gjejnë vend në ndryshimet e Kodit Zgjedhor?**

**Lipponen:** I takon sistemit parlamentar të vendosë për këtë. Sigurisht që komentet kontribuojnë në diskutime, por i takon sistemit parlamentar të bëjë një vlerësim të këtij kontributi.

**TVA: A do të ketë tryezë nga OSBE-ja për partitë politike për të shpejtuar ndryshimet në Kod, pasi të merrni sinjal se rekomandimet janë pranuar nga dy partitë më të mëdha?**

**Lipponen:** Ne presim komente kur të gjithë të kenë pasur kohë ta studiojnë raportin e fundit. Atëherë do të jetë koha për të dalë në përfundime se cilat do të jenë rrugët që do të ndiqen në trajtimin e kësaj çështjeje dhe cili do të jetë procesi i negociimit. Unë jam i sigurt se do të ketë edhe tryeza të rrumbullata. Se çfarë temash do të diskutohen në këto tryeza, kjo është një çështje tjetër.

**TVA: Partia Demokratike po shqyrton mundësinë për të mos u futur në zgjedhje me Nanon kryeministër. Sa i drejtë ju duket ky opsion?**

**Lipponen:** Ju thatë që Partia Demokratike po e shqyrton këtë ide. Partia Demokratike nuk e ka marrë një vendim të tillë. Çdo parti në demokraci ka të drejtë të bëjë zgjedhjet e saj. Se çfarë është konstruktive dhe e mirë për vendin, kjo është, sigurisht, një çështje tjetër. Personalisht, unë nuk besoj se ndokush do të merrte një vendim të tillë në këtë situatë të rëndësishme politike, pasi zgjedhjet janë rruga e vetme për të fituar pushtet dhe për të parë se çfarë mbështetjeje kanë. Sigurisht, zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe të ndershme.

**TVA: Çfarë ndikimi do të ketë suksemi apo dështimi i zgjedhjeve për të ardhmen e Shqipërisë?**

**Lipponen:** E kemi thënë në disa raste se zgjedhjet e ardhshme do të jenë vendimtare. Duhet të rivendoset besimi në sistemin zgjedhor dhe atë politik. Pas një sërë zgjedhjesh të kundërshtuara gjithmonë nga dikush dhe komenteve ndërkombëtare mjaft kritike e të forta, ka ardhur koha që demokracia shqiptare të funksionojë e të arrijë rezultate. Ekziston edhe një aspekt tjetër, i cili është theksuar kohët e fundit në disa komente ndërkombëtare: zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë, në një farë mënyre, bileta për integrimin, si në strukturat e sigurimit, ashtu edhe në ato evropiane.